



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
 Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 5 dhe 16 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 08/2013 për Ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391, dt.25.02.2010, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-195330/23 dt. 21.09.2023, të aplikuesit/subjektit juridik “Henderson Asset Protection” LLC, me seli në Prishtinë, rr. “Ekrem Rexha” nr. 27, Prishtinë, për lejin e renovimit të pjesës së ndërtesës ekzistuese/njesisë banesore, e cila gjendet në rr. “12 Qershori” nr. 15 në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 04.12.2023, merr këtë:

V E N D I M
 PËR LEJIMIN E ZHVILLIMIT TË PUNIMEVE PËR RENOVIMIN E
 NDËRTESES EKZISTUESE

I. MIRATOHET kërkesa 05 Nr. 350/02-195330/23 dt. 21.09.2023, e aplikuesit/subjektit juridik “Henderson Asset Protection” LLC, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 810483537, dhe me pronar Duncan Richard Bullivant nga Britania e Madhe, për lejin e zhvillimit të punimeve për renovimin e pjesës së ndërtesës ekzistuese/njesisë banesore, me etazhitet B+P, e evidentuar në certifikatën e njesisë kadastrale nr. O-71914059-1188-3-1-0 dhe O-71914059-02902-1-1188-2-1-0, ZK Prishtinë, përkatësisht në lagjen “Kalabria”, rr. “12 Qershori” nr. 15 në Prishtinë.

II. Me këtë vendim/pëlqim, miratimi i kërkesës sipas pikës I të dispozitivit të këtij akti, ka të bëjë me lejin e zhvillimit të punimeve, sipas dokumentacionit ndërtimor/projektit të prezantuar, si në vijim:

- a) Punët e rregullimit të jashtëm të oborrit
- b) Punët e muratimit
- c) Punët e suvatimit dhe ngjyrosjes
- d) Punët me llamarinë
- e) Punët e zdrukthtarisë
- f) Punët e dritareve dhe dyerve nga PVC-ja
- g) Punët e fasadës
- h) Punët e kulmit
- i) Punët e estrihut dhe dyshemesë
- j) Instalimi dhe montimi i kamerave.

III. Zhvillimi i punimeve të përshkuara në pikën II. të dispozitivit të këtij akti, duhet të bëhet nga ekipet profesionale, duke mos cenuar gjendjen ekzistuese të ndërtesës dhe duke mos dëmtuar infrastrukturën ekzistuese nën dhe mbi tokë (me mbikëqyrje të profesionistëve të lëmive përkatëse), dhe sipas dokumentacionit ndërtimor/projektit të prezantuar, i hartuar nga kompania projektuese “Archlink Studio” shpk, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 811330068, dhe i cili do të jetë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV. Renovimi i ndërtesës ekzistuese/njësve banesore të bashkëpronësisë nga pika I e dispozitivit të këtij akti, do të bëhet me qëllim të mirëmbajtjes dhe krijimit të kushteve të pranueshme për shfrytëzim bazuar edhe në nenin 5, paragrafi 1.3, të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, punët ndërtimore për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimore janë “ riparimi-renovimi, sanimi, rehabilitimi-përmirësimi” si dhe bazuar në Nenin 3, paragraf 1.11. të po këtij ligji punët që përfshihen në riparim janë “Riparimi-kthimi i një objekti në kusht të pranueshme duke bërë ripërtitjen, zëvendësimin, apo rregullimin e pjesëve të dëmtuara ose të degraduara”.

V. Poseduesi i këtij vendimi/pëlqimi është i obliguar që së paku 7 ditë para fillimit të punimeve të lajmërojë Drejtorinë e Inspeksionit, për fillimin e zhvillimit të punimeve, si dhe të ndërmerr masat

adekuate të sigurisë së vend ndërtimit, dhe gjatë punimeve të mos rrezikojë jetën dhe pasurinë e personave të tretë.

VI. Nëse kërkuesi nuk i përmbahet këtij vendimi/pëlqimi, dhe kryen punime tjera nga ato të përshkuara në pikën I. të dispozitivit të këtij akti, ky vendim/pëlqim pushon së vlejuri, ndërsa punimet do të trajtohen ilegale.

VII. Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 16 *Ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi* të Ligjit Nr. 04/l-110 për Ndërtim, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 08/2013 për Ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi dhe të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, këto punë ndërtimore nuk konsiderohen si ndërtim e as rindërtim, dhe për to nuk është paraparë pagesa e taksës administrative për leje të ndërtimit e as ndonjë taksë tjetër komunale.

VIII. Vendimi/pëlqimi për lejimin e zhvillimit të punimeve renovuese vlen 1 (një) vit nga dita e lëshimit, me të drejtë vazhdimi edhe për një vit tjetër, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë të këtij akti.

Ar sy e t i m

Aplikuesi/subjekti juridik "Henderson Asset Protection" LLC, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 810483537, dhe me pronar Duncan Richard Bullivant nga Britania e Madhe, me kërkesën 05 Nr. 350/02-195330/23 dt. 21.09.2023, ka kërkuar nga kjo drejtori, lejimin e zhvillimit të punimeve për renovimin e pjesës së ndërtesës ekzistuese/njesisë banesore, me etazhitet B+P, e evidentuar në certifikatën e njesisë kadastrale nr. O-71914059-1188-3-1-0 dhe O-71914059-02902-1-1188-2-1-0, ZK Prishtinë, e cila gjendet në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të këtij vendimi/pëlqimi.

Me kërkesën 05 Nr. 350/02-195330/23 dt. 21.09.2023, është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

Dëshmia mbi pronësinë/certifikata e njesisë kadastrale nr. O O-71914059-1188-3-1-0 dhe O-71914059-02902-1-1188-2-1-0, ZK Prishtinë lëshuar nga Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;

Pjesa grafike/ projekti ideor i renovimit, i hartuar nga kompania projektuese "Archilink Studio" shpk, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 811330068;

- Manuali "Situacioni gjeodezik në parcelën 2902-0", i punuar nga gjeodeti i licencuar Faton H. Bajselmani, me licencë nr. 125;
- Vërtetimi mbi obligimet tatimore në emër të "Henderson Asset Protection" LLC, nr. 10-430/03-0190464/23 dt. 13.09.2023;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit të "Henderson Asset Protection" LLC, nr. 810483537;
- Kopja e letërnjoftimit e personit të autorizuar.

Drejtorja e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, pas pranimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-195330/23 dt. 21.09.2023, shqyrtimit të përmbajtjes së saj, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative për atë hapësirë, konstatoi se

Aplikuesi, me kërkesën në trajtim, ka kërkuar nga kjo drejtori, lejimin e zhvillimit të punimeve për renovimin e pjesës së ndërtesës ekzistuese/njesisë banesore, me etazhitet B+P, e evidentuar në certifikatën e njesisë kadastrale nr. O-71914059-1188-3-1-0 dhe O-71914059-02902-1-1188-2-1-0, ZK Prishtinë.

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të dokumentacionit ndërtimor të prezantuar, konstatimeve të lartcekura, dhe pas konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 5 dhe 16 *Ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi* të Ligjit Nr.04/l-110 për Ndërtim, dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 08/2013, për ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi, në të cilat rregullativa janë të specifikuar llojet e punimeve që mund të zhvillohen pa u pajisur me leje ndërtimi, është konstatuar se punimet ndërtimore për të cilat është kërkuar lejimi i zhvillimit të tyre, nuk trajtohen ndërtim e as rindërtim, kryesisht, janë punime për mirëmbajtjen e ndërtesës, për renovimin e rrjetit të instalimeve ekzistuese, për ndërmarrjen e masave të efijencës energjetike të ndërtesës, dhe se për zhvillimin e atyre punimeve, nuk kërkohet leje ndërtimi.

Andaj, bazuar në konstatimet e lartshënuara dhe në kërkesën e prezantuar, përkatësisht në përshkrimin e punimeve në dokumentacionin ndërtimor/projektin e prezantuar, konform nenit 16 *Ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi* të Ligjit Nr. 04/l-110 për Ndërtim, dhe Udhëzimit

Administrativ të MMPH-së Nr. 08/2013, për ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi, është konstatuar se për zhvillimin e punimeve të njëjta nuk kërkohet leje ndërtimi, andaj kjo drejtori, vendosi që këtë kërkesë ta trajtojë përmes dhënies së pëlqimit për zhvillimin e punimeve, sipas përshkrimit në paragrafin I të dispozitivit të këtij akti.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi/pëlqimi.

Shtojcë: Situacioni i gjerë.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim / pëlqim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimet nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u përpilua në pesë (5) kopje identike dhe i dorëzohet: Aplikuesit, Drejtorisë së Inspeksionit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-195330/23 dt. 21.09.2023.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-195330/23 DT. 04.12.2023**

Zyrtari,
Anisa Osmani



Udhëzimi





PROJEKTUSI:



INVESTORI:
Henderson Asset Protection L.L.C.

PROJEKT:
PROJEKTI IDEOR I RENOVIMIT PER
SHTEPIË E BANIMIT B+P+0

VERSHI:
Pristinë, Kaldorri
Njësitë kod. P-71914059-02902-0



PROJEKTANT:

ADELINA ALLIJA
[Signature]

PROJEKTANT:

LIRIDON KALLABA
[Signature]

PROJEKTANT:

LOKACIONI I GJERË

DATA: NOË 4, 2021

ORIENTIMI: 1:100



SH.M.T.
"28 NENTORI"

17. QERSHORI

DDN BOSKO

SHTEPIA
B+P+0

STACIONI I
AUTOBUSEVE

DUKAGJINI

BARDHOSH GERVALLA

BILL KLINTON